

R A P O R T
i
SEMINARIT KOMBETAR
“Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri”

1 Hyrje

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, me mbështetjen e SNV, SIDA-s dhe të Bankës Botërore, ndërmorrën iniciativën për të organizuar në datat 12 dhe 13 Mars 2008, në Hotel Tirana internacional, seminarin dy ditor me temë “*Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri*”.

Seminari synoi të lehtësojë dialogun e hapur dhe konstruktiv ndërmjet aktorëve kryesorë në Shqipëri mbi kuadrin ligjor që lidhet me mbarështrimin e burimeve natyrore (pyje, kullota, etj.) në pronësi/përdorim të komunave, fshatrave, familjeve, grupeve të fermerëve apo individëve dhe të diskutojë mbi përmirësimet e nevojshme të ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse. Gjithashtu seminari synonte të vlerësonte boshllëqet dhe paqartësitë e kuadrit ligjor aktual dhe të bënte propozime të qarta për përmirësimin e dispozitave legjore ekzistuese.

Seminari pati dy objektiva kryesorë:

- i) Shkëmbimin e njohurive dhe pikpamjeve midis pjesëmarrësve mbi politikën dhe legjislacionin dhe identifikimi i boshllëqeve dhe paqartësive të kuadrit ligjor aktual për mbarështrimin e burimeve natyrore (në pronësi/përdorim) nga komunat, organizatat me bazë komuniteti apo pronarët privatë, me një fokus specifik mbi pyjet dhe kullotat.
- ii) Propozimi i përmirësimeve të nevojshme në kuadrin ligjor ekzistues: a) për të rivlerësuar sigurinë e pronësisë dhe të drejtat e pronësisë në pyje e kullotat komunale, b) për të nxjerrë në pah dhe rivlerësuar të drejtat për të krijuar të ardhura apo përfitime nga përdorimi i pyjeve e kullotave komunale; duke synuar mbarështrimin e qëndrueshëm në të ardhmen dhe gjenerimin e të ardhurave.

Për drejtimin e përgjithshëm të seminarit në drejtim të përgatitjes dhe organizimit, koordinimit të kontributeve të institucioneve të ndryshme, miratimit të programit të seminarit, etj., u krijuar një komitet drejtues me përbërje si më poshtë:

1. Z. Taulant Bino, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,
2. Znj. Drita Dade, Banka Botërore,
3. Z. Peter Troste, SIDA,
4. Z. Jack Cortenraad SNV Albania,
5. Z. Thimaq Lako, Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale.

Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale (SHKPKK) siguroi mbështetjen organizative për përgatitjen dhe zhvillimin e Seminarit Kombëtar “Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri”.

Procedurat dhe zhvillimi i seminarit

1.1 Para seminarit

Faktori kyç për sukses të vazhdueshëm në realizimin e pylltarisë komunale në Shqipëri është ekzistenca e një kuadri ligjor të qartë e të plotë, i cili të lejoje dhe të mbështesë të gjitha veprimtaritë që lidhen me mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale, përfshi të drejtat e pronësisë e të përdorimit; të drejtat për mbarështrimin dhe shfrytëzimin e pasurive pyjore e kullimore komunale; të drejtat për perpunimin dhe tregëtimin e prodhimeve dhe marketimin e shërbimeve; të drejtat për mbledhjen e gjobave dhe taksave, si dhe administrimin dhe rinvestimin e fondeve publike e private në këtë sektor. Një varg aktesh ligjore e nënligjore të nxjerra pas viteve '90 kanë mundur kalimin e pyjeve dhe kullotave në përdorim komunal.

Procesi i kalimit ka filluar në vitin 1996 nën drejtimin e DPPK në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe Shërbimin Pyjor në rrethe, si dhe me mbështetjen teknike e financiare të Projektit të Pyjeve të Bankes Botërore (PP/BB), të Programit për Zhvillimin e Pylltarisë Private në Shqipëri (APFDP), i financuar nga USAID. Aktualisht vazhdojnë të mbështesin këtë proces PZHBN, SNV dhe organizmat e tjere ndërkombëtare. Aktualisht në Drejtorinë e Politikave Pyjore e Kullotave të MMPAU funksionon një Sektor i Pyjeve dhe Kullotave Komunale.

Duke synuar që të mbështesë Shqipërinë në drejtim të një qeverisje më të mirë dhe për uljen e varfërisë, SNV është përfshirë që në vitin 1999 në organizimin e aktivitetit që lidhen me pyjet komunalë, në nivele të ndryshme angazhimi dhe në kooperim me aktorë të ndryshëm, lokalë ose ndërkombëtarë. Një nga këta aktorë është Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale (SHKPKK), e cila përfaqëson një rrjet të gjerë të Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale dhe të Federatave të tyre.

Me gjithë arritjet, është shprehur shqetësimi për ritmet e ngadalta, procesi në asnjë komunë nuk mund të quhet i përfunduar pasi ende nuk janë njohur ligjërisht kufijtë midis komunave, fshatrave dhe pyjeve e kullotave të përdoruesve, përdoruesit nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojë të drejtat e tyre ekskluzive të përdorimit mbi atë pyll ose kullotë dhe këto as janë regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme, etj. Po ashtu, mjaft probleme qëndrojnë për të gjitha komunat ku do të behet kalimi i parashikuar për të përfunduar brenda një kohe të shkurtër (gjashtëmujori i parë 2008), sipas porosit të Kryeministrit të Shqipërisë dhe programit të masave që ka hartuar Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU).

Për të patur një pamje më të qartë të problemeve dhe për të dhënë ndihmesën e vet në këtë proces të rëndësishëm, SNV dhe SHKPKK vendosën të ngarkojnë një Konsulent për të bërë një analizë të hollësishme të kuadrit aktual ligjor dhe të ndikimeve të tij mbi praktikën e pylltarisë komunale në Shqipëri.

Objektivat për analizën e kuadrit ligjor për pyjet dhe kullotat komunale në Shqipëri, sipas termave të referencës, kanë qënë:

1. Kryerja e inventarit të plote dhe analiza e ligjeve, vendimeve e rregulloreve që ndikojnë mbi mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në të gjitha aspektet e veta:
 - të drejtat e pronësisë e të përdorimit;
 - të drejtat e përgjegjësisë për mbarështrimin, shfrytëzimin dhe ruajtjen e pasurive pyjore e kullimore;
 - të drejtat për perpunimin dhe tregëtimin e prodhimeve dhe marketingun e produkteve, shërbimeve, etj. (të drejtat ekonomike dhe tregtare);

- te drejtat per mbledhjen e gjobave dhe taksave, si dhe per administrimin dhe riinvestimin e fondeve publike e private ne kete sektor (te drejtat fiskale dhe administrative);
- 2. Identifikimi i mangesive ne aktet dhe rregulloret e vecanta te permendura me lart, mbivendosjet, konfliktet apo boshlleqet midis tyre, duke theksuar vecanerisht ato qe rendojne mbi interesat e perdoruesve vendore te pyjeve (dhe strukturat organizative te tyre);
- 3. Propozime per rruget qe duhen ndjekur per zgjidhjen e mangesive te verejtura.

Studimi “Analiza e kuadrit ligjor për pyjet dhe kullotat komunale në Shqipëri” u mundësua me mbështetjen e projektit SNV-SIDA 7300060801 “Forcimi i mbarështrimit të qëndrueshëm të pylltarisë komunale – Nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të kapaciteteve për mbarështrimin e pyllit të fermerit”.

Programi i seminarit (aneksi A) u fokusua në dy elementë kryesorë:

- i) Një seri prezantimesh nga folësit e ftuar, që u adresohen elementëve të rëndësishëm të politikës dhe kuadrit ligjor për qeverisjen e pyjeve dhe kullotave komunale në Shqipëri, të analizuar nga këndvështrime të ndryshme.
- ii) Diskutime në grup, të organizuara për çështje specifike që janë identifikuar në raportin “Analiza e kuadrit ligjor për pyjet dhe kullotat komunale në Shqipëri” si komponentë kryesorë për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave komunale dhe të legjislacionit që lidhet me to..

Në seminar muarrën pjesë 84 persona, ndërmjet tyre përfaqësues të institucioneve qëndrore ligjvënëse dhe qeveritare e të organizatave ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të njërive të qeverisjes vendore, të shoqërisë civile, të sektorit privat, të institucioneve kërkimore, etj. Në seminar gjithashtu ishin të pranishëm vëzhgues nga vendet fqinjë (Kosova dhe Maqedonia) dhe një përfaqësues nga Konfederata Europiane e Pronarëve të Pyjeve Privatë.

1.2 Aktivitetet e seminarit

Seminari Kombëtar “Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri” u hap më 12 Mars 2008, me pjesëmarrjen e më shumë se 80 personave (lista e plotë e pjesëmarrësve jepet në aneksin B).

Z. Thimaq Lako, SHKPKK hapi seminarin duke falenderuar Ministrin e MMPAU, Z. Lufter Xhuveli, deputetët Z. Rexhep Uka, Z. Idriz Xhomara, Z. Petrit Gjoni, përfaqësuesit e donatorëve nga BB, SIDA-s dhe SNV, përfaqësuesit nga Kosova dhe Maqedonia, përfaqësuesin e Konfederatës Europiane të Pronarëve të Pyjeve Privatë, si dhe të gjithë pjesëmarrësit nga Shqipëria për vlerësimin dhe pjesëmarrjen e tyre në seminar.

Ministri i MMPAU, Prof. Dr. Lufter Xhuveli ju uroi mirseardhjen të gjithë pjesëmarrësve të Seminarit Kombëtar nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (shih programin e seminarit, aneksi A). Ministri nënvizoi rëndësinë e transferimit të pyjeve e kullotave komunale në pronësi ose përdorim të njërive të qeverisjes vendore (komunave e bashkive) dhe rolin udhëheqës të Ministrisë në këtë proces. MMPAU, në kuadër të përmirësimit dhe të zbatimit të politikave pyjore, e konsideron kuadrin ligjor si një nga instrumentat më të rëndësishëm për transferimin e pyjeve dhe kullotave tek NJQV. Gjatë dy viteve të fundit Ministria ka përfshirë aktivisht të gjithë aktorët në procesin e përgatitjes të dispozitave ligjore për qeverisjen e pyjeve dhe kullotave komunale në Shqipëri. Ne procesin e konsultimeve të gjera të zhvilluara me aktoret e interesit në përgatitjen e akteve ligjore dhe nenligjore, MMPAU

vlereson mjaft kontributin qe kane dhene edhe Shoqatat e perdoruesve te pyjeve dhe kullotave, Federatat rajonale dhe ajo kombetare, por edhe donatatore te huaj si Banka Boterore, SNV etj..

Në këtë këndvështrim, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave e çmon shumë të rëndësishëm edhe kete semiar kombetar qe po zhvillohet sot me teme: “Permiresimi i kuadrit ligjor per mbareshtimin e qendrueshem te pyjeve dhe kullotave komunale”. Ne “Strategjine e pyjeve dhe Kullotave”, procesi i decentralizimit të burimeve pyjore dhe kullosore konsiderohet si një nga drejtimet më të rëndësishme të mbarështrimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave dhe vetëm gjatë 5 muajeve të fundit procesit te transferimit te pyjeve dhe kullotave tek njesite e qeverisjes vendore është përshpejtuar dukshëm nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave ne bashkepunim te ngushte me Ministrine Brendeshm nëpërmjet angazhimit të strukturave të tyre në qendër dhe në bazë për përgatitjen e projektvendimeve per transferimin e pyjeve dhe kullotave tek njesite e qeverisjes vendore.

Diskutimet dhe konkluzionet qe do të arrihen gjate ketij seminari dy ditor do te qartesojne me mire adresimin e problematikes qe lidhet me permiresimin e kuadrit ligjor per menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunale dhe do te jene ne qender te vemendjes ne punen tone te ardheshme.

Z. Jack Cortenraad, Drejtor i SNV Shqipëri, vlerësoi organizimin e këtij seminari dhe i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre. Z. Cortenraad theksoi se SNV punon në Shqipëri që nga viti 1999, në fillim me Projektin Shqiptar të Pyjeve në DDiber dhe që nga viti 2005 është duke u shtrirë në rajonet e tjera. Sot, në kuadër të Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN), të financuar nga Banka Botërore dhe SIDA, SNV ka shtrirë aktivitetin e saj në 12 qarqe të Shqipërisë. PZHBN forcon kapacitetet e të gjithë aktorëve në pylltarinë komunale dhe synon të sigurojë që pyjet dhe kullotat e Shqipërisë të qeverisen në një mënyrë të qëndrueshme për të gjeneruar të ardhura, në përputhje me politikat kombëtare dhe aapiratat e Bashkimit European.

SNV Shqipëri, në partneritet me Ministrinë, Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve Komunalë, SIDA dhe Bankën Botërore, ka mundësuar zhvillimin e kapaciteteve të shumë shoqatave të përdoruesve të pyjeve. Këto shoqata tashmë luajnë një rol kyç në zonat rurale. Vetëm gjatë vitit 2007 këto shoqata organizuan 1080 trajnime në 1080 fshatra të përfshira në 120 komuna. Tashmë këto shoqata janë të afta të luajnë rolin e tyre në zhvillimet e reja të pyjeve komunale dhe në gjenerimin e të ardhurave nëpërmjet mbarështrimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave komunale.

Z. Cortenraad nënvizoi rëndësinë e për krijimin e një kuadri ligjor e rregullator të qartë e lehtësues. Seminari “Permiresimi i kuadrit ligjor per mbareshtimin e qendrueshem te pyjeve dhe kullotave komunale” ka rëndësi për gjenerimin e të ardhurave dhe zhvillimin e ekonomive rurale në shume krahina të Shqipërisë, sidomos në ato zona rurale ku jetojnë shumë njerëz të varfër.

Z. Taulant Bino, Zëvendës Ministër i MMPAU, prezantoi strategjinë për zbatimin e programit të Qeverisë për transferimin e pyjeve dhe kullotave shtetërore në pronësi/përdorim të komunave e bashkive. Z. Bino nënvizoi rolin aktiv të ministrisë për zbatimin e strategjisë për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri dhe reformën institucionale, të miratuar nga Këshilli i Ministrave më 23.4.2004. Ndërkohë gjatë vitit 2007 vëmendja e Ministrisë ka qënë fokusuar në përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me pyjet, kullotat dhe bimët mjekësore.

MMPAU e konsideron Projektin per Zhvillimin e Burimeve Natyrore si pjese thelbesore per realizimin e reformave ne fushen e decentralizimit dhe te zhvillimit te zonave rurale. Per kete qellim dhe ne perputhje me kerkesat e vazhdueshme te Bankes Botërore dhe SIDA-s, Qeveria e Shqipërisë ka marrë një numër masash për të përshpejtuar procesin e transferimit te pyjeve dhe kullotave në pronësi/përdorim të njësive të qeverisjes vendore.

Për arritjen e objektivave të Qeverisë, MMPAU ka përgatitur një plan veprimi për zbatimin e strategjisë për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi/përdorim të komunave dhe për qeverisjen e qëndrueshme të tyre. Plani i mësipërm i veprimit është hartuar bazuar në strategjinë e Qeverisë së Shqipërisë dhe porosinë e Kryeministrit për pershpejtimin e transferimit të pyjeve dhe kullotave në NJQV. Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për transferimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve dhe kullotave në pronësi/përdorim të komunave është miratuar më 29 tetor 2007 nga Ministri i MMPAU

Objektivat kryesore të MMPAU per transferimin e pyjeve dhe kullotave prane NJQV jane si me poshte:

- Te zgjerohet dhe pershpejtohet programi qeveritar per dhenien ne perdorim/pronesi te pyjeve dhe kullotave komunave me qellim qe te arrihen synimet per transferimin e pyjeve dhe kullotave brenda 6 mujorit te pare te vitit 2008 ne te gjitha komunat e vendit;
- Ne zbatim te ligjeve te pyjeve, kullotave, gjuetise e bimeve mjekesore te pergatiten aktet nenligjore per shfrytezimin nga komunat te pyjeve e kullotave komunale;
- Te sistematizohet, forcohet dhe thjeshtohet procesi i kalimit te pyjeve dhe kullotave nga shteti te komunat;
- Te riskicohet Sherbimi Keshillimor ne vartesi te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave per te riorientuar rolin e pylltareve ne mbareshtimin dhe mbrojtjen e pyjeve
- Te nxiten NJQV ne ngritjen e strukturave vendore (zyrat e administrimit te tokes) si dhe te personelit per administrimin e pyjeve dhe kullotave komunale.

Nje grup i perbashket i administrates se MMPAU dhe agjencise kombetare per Transferimin e pronave te paluajtshme koordinon per zbatimin e programit te parashikuar ne planin e veprimeve te permendur me lart sipas grafikut të miratuar.

MMPAU dhe Drejtorite e Sherbimit Pyjor (DSHP) ne rrethe, ne bashkepunim me Agjencine e Mjedisit dhe Pyjeve, dhe Projektin per Zhvillimin e Burimeve Natyrore, sipas afateve te percaktuara, po punojne ngushtesisht me administratat e komunave dhe shoqatat e perdoruesev te pyjeve e kullotave komunale per te percaktuar saktesisht ngastrat pyjore dhe kullosore qe transferohen tek NJQV.

Sherbimi pyjor i Shqiperise po përgatitet për të kryer tashme rolin e sherbimit keshillimor ne funksion te keshillimit te NJQV per nje transferim te pyjeve dhe kullotave ne menyre me te shpejte dhe me te koordinuar. Per te nxitur dhe mireorganizuar kete sherbim keshillimor, është ngritur nje Grup Pune i kryesuar nga Zevendesministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave, i cili ka hartuar rekomandimet dhe programin e punes per kete qellim.

Për trajnimin e personelit në kuadër të Shërbimit Këshillimor Pyjor në nivel NJQV po punohet për identifikimin e personelit të mësipërm dhe ndërkohë po punohet për vlerësimin e nevojave për trajnim, ndërkohë që programi i trajnimit do të hartohet dhe zbatohet me mbështetjen e PZHBN.

Znj. Dhurata Çupi, Drejtoreshë e Agjensisë Kombëtare për Transferimin e Pronave të Palujtëshme, Ministria e Brendëshme, prezantoi proceset për zbatimin e strategjisë për transferimin e pronave shtetërore në komuna e bashki, duke u fokusuar më shumë në kontekstin dhe në metodologjinë e përdorur. Ministria e Brendëshme po punon për zbatimin e strategjisë për decentralizimin e pushtetit vendor dhe në këtë kuadër decentralizimi i qeverisjes së pyjeve dhe kullotave është pjesë përbërëse e strategjisë së Ministrisë së Brendëshme.

Znj. Çupi nënvizoi faktin se aktualisht kuadri ligjor për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi/përdorim të komunave e bashkive është i plotë dhe bazohet në nenin 3 të ligjit nr.8744, date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesite e qeverisjes vendore", të ndryshuar, në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.500, date 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njesite e qeverisjes vendore", pika 4, në ligjin nr.9385, date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.396, date 21.06.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore".

Ministria e Brendëshme, në bashkëpunim të ngushtë me MMPAU ka punuar për zbatimin e strategjisë për transferimin e pyjeve dhe kullotave shtetërore në pronësi/përdorim të komunave/bashkive. Agjencia Kombëtare për Transferimin e Pronave të Palujtëshme, në bashkëpunim të ngushtë me SNV dhe PZHBN ka zhvilluar disa seminare rajonale me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunave dhe të Shërbimit Pyjor për të sqaruar procedurat për transferimin e pyjeve dhe kullotave shtetërore.

Znj. Çupi në fund theksoi se vullneti politik për të përshpejtuar procesin e transferimit të drejtave të pronësisë/përdorimit të pyjeve dhe kullotave në komuna e bashki duhet të shoqërohet njëkohësisht edhe me procesin e informimit dhe të ndërgjegjësimin të njësive të qeverisjes vendore.

Z. Rexhep Uka, Deputet, prezantoi veprimtarinë e Forumit Parlamentar për Zhvillimin e Zonave Malore. Z. Uka informoi pjesëmarrësit lidhur me krijimin e grupit parlamentar për zhvillimin e Onave malore. Puna e antarëve të këtij grupi parlamentar është fokusuar për të kontribuar me angazhimin e tyre kryesisht në disa drejtime:

- Lobimin pranë Parlamentit shqiptar, institucioneve kombëtare qendrore, civile, lokale si dhe ato ndërkombëtare për përshpejtimin e zhvillimit të qendrueshëm dhe të integruar të zonave malore në ekonomine kombëtare dhe me gjere.
- Zhvillimi i politikave dhe legjisllacionit shqiptar me synim promovimin e zhvillimit të qendrueshëm dhe të integruar të ZM.
- Identifikimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve lobuese pranë institucioneve kombëtare, qendrore dhe lokale si dhe institucioneve ndërkombëtare.
- Nxitja e harmonizimit të nderhyrjeve dhe politikave zhvillimore ekonomike, mjedisore dhe sociale me qëllim rritjen e nivelit të integritetit dhe kontributit të zonave malore në ekonomine kombëtare.
- Nxitja e sensibilizimit të opinionit për vlerat, burimet dhe potencialet ekonomike dhe shoqërore që përmbajnë në vetvete këto zona si dhe nevojën e zhvillimit të tyre të metejshëm. Mbështetja e veprimtarisë së Forumit Kombëtar të Zonave Malore dhe zhvillimit të tij në një institucion lider dhe efektiv, të tipit Europian, në mbështetje të zhvillimeve rajonale dhe kombëtare.
- Rishikimin e legjisllacionit që prek zonat malore dhe propozimi i disa përmirësimeve të nevojshme;
- Draftimin dhe dorëzimin në Parlament të një Ligji specifik për zonat malore, që është ambicja qendrore e forumit për zhvillimin e zonave malore.

Sipas Z. Uka hartimi i nje ligj i ri per pyjet, qe duhet te marre ne konsiderate 1) menaxhimin i pyjeve shteterore ne administrim te sherbimit pyjor, 2) mbareshtimi i pyjeve ne pronesi te komunave ose bashkive dhe te perdoruesve tradicionale (fshat, familje bujqesore, shoqate e perdoruesve); dhe 3) mbareshtimi i pyjeve private eshte një detyrë imediate.

Z.. Thimaq Lako, SHKPKK prezantoi shkurtimisht dinamikën aktuale të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave komunale në Shqipëri. Në prezantim u theksua se procesi i transferimit të pyjeve dhe kullotave komunale dhe mbarështimi i tyre bazohet në pjesëmarrjen aktive të komunitetit. Kjo përjasje bazohet në disa parime si (i) fokusimi tek njerëzit dhe jo tek drurët; (ii) procesi i mbarështimit bëhet nga vendasit dhe jo nga të ardhurit; (iii) pjesëmarrja aktive e antarëve të komunitetit gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të planit të mbarështimit; (iv) marrja përsipër jo vetëm e të drejtave, por edhe të përgjegjësisë; (v) trajnimi dhe krijimi i kapaciteteve, etj.

Eksperienca shqiptare ka treguar se shoqatat e përdoruesve të pyjeve e kullotave janë strukturat bazë për të realizuar me sukses procesin e transferimit dhe qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve komunale. Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, me nismën e tyre kanë krijuar federatat rajonale, të cilat më pas kanë krijuar Shoqatën Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale. Këto struktura bashkëpunojnë ngushtësisht me NJQV dhe Shërbimin Pyjor. Drejtimet kryesore ku duhet të përqëndrohet puna për përfundimin e procesit të transferimit të pyjeve dhe kullotave komunale në pronësi/përdorim të NJQV, sipas SHKPKK janë:

- Përmirësimi i politikave dhe instrumentave për mbarështimin me pjesëmarrje të P&KK.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për transferimin e P&KK në pronësi të NJQV dhe mbarështimi i qëndrueshëm nga banorët.
- Nxitja e gjenerimit të të ardhurave nga mbarështimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të NJQV.
- Krijimi i një shërbimi këshillimor efektiv për pyjet dhe kullotat komunale, etj.

Z. Vezir Muharremaj prezantoi studimin “Analiza e kuadrit ligjor ekzistues në Shqipëri mbi pyjet dhe kullotat komunale” study, i cili u mundësua me mbështetjen e projektit SNV-SIDA 7300060801 “Forcimi i mbarështimit të qëndrueshëm të pylltarisë komunale – Nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të kapaciteteve për mbarështimin e pyllit të fermerit”.

Z. Muharremaj përmendi që në kuadrin e politikave për decentralizimin e qeverisjes së pasurive natyrore dhe legalizimin e informalitetit të hershëm në posedimin e pyjeve dhe kullotave pranë fshatrave, si dhe për integrimin në BE, procesi i kalimit të pyjeve dhe kullotave në pronesi ose përdorim të komunave e bashkive është bërë tashmë një problem që preokupon qeverinë qendrore dhe njesitë e qeverisjes vendore, përdoruesit (fshatrat, familjet bujqesore) dhe shoqatat e tyre në mbare vendin. Aktet ligjore e nenligjore të nxjerre pas viteve '90, si ligji për pyjet, ligji për kullotat e livadhet, Rregullorja Nr. 308, datë 26.01.1996 “Për kalimin e pyjeve dhe kullotave komunale për përdorim dhe administrim”, ligji për qeverisjen vendore (2000), ligji për pronat publike dhe ligji për transferimin e tyre (2001), etj., kanë mundësuar kalimin e pyjeve dhe kullotave në përdorim komunal. Në bashkëpunim me DPPK, me njesitë e qeverisjes vendore dhe shërbimin pyjor në rrethe, procesi i kalimit filloi në vitin 1996, me mbështetjen teknike e financiare të Projektit të Pyjeve të BB, të Programit për Zhvillimin e Pylltarisë Private në Shqipëri (APFDP) i financuar nga USAID, dhe vazhdojnë të mbështesin këtë proces PZHBN, Organizata Hollandeze për Zhvillimin (SNV) dhe organizma të tjera ndërkombëtare. Në Drejtorinë e Politikave për Pyjet e Kullotat pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe

Administrimit të Ujrave (MMPAU) tashme funksionon Sektori i Pyjeve dhe Kullotave Komunale.

Deri në fund të vitit 2006 ishin transferuar 341,000 ha pyje dhe 93,000 ha kullota. Në proces janë përfshirë 138 komuna, me 1,290 fshatra e 160,118 familje. Në fshatra janë krijuar komisionet e pyjeve dhe kullotave, si dhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve e kullotave komunale, federatat rajonale dhe Shoqata Kombëtare. Në këtë mënyrë ka filluar një nga aspektet më të rëndësishme të reformës në pyje e kullota.

Gjatë procesit të kalimit është fituar një përvojë e mirë, pasi mjaft familje bujqesore janë të njohura me procesin, megjithatë jo plotësisht; përdoruesit janë angazhuar për mbrojtjen dhe qeverisjen e pyjeve dhe kullotave të tyre dhe kudo sheh pyje të përmirësuar nga familjet që i zoterojnë; planet e mbarështrimit kanë filluar të zbatohen nga shoqatat, të financuara nga PP i BB, PZHBN dhe SNV; ka filluar të ndryshojë qëndrimi i njesive të qeverisjes vendore dhe i pylltarëve për pyjet e kullotat komunale. Në linjen e shërbimit pyjor, MMPAU është ngarkuar si autoriteti përgjegjës për monitorimin e kalimit dhe mbareshtrimit të pyjeve dhe kullotave komunale; në rrethë janë DSHP-te. Në linjen e qeverisjes vendore, në një numër komunash janë caktuar pylltarët komunale. Pylltarë komunale janë caktuar dhe në disa SHPPKK.

Më gjithë arritjet, është shprehur shqetësimi për ritmet e ngadalta, procesi në asnjë komunë nuk mund të quhet i përfunduar pasi ende nuk janë njohur ligjërisht kufijtë midis komunave, fshatrave dhe pyjeve e kullotave të përdoruesve, përdoruesit nuk kanë asnjë dokument që të vërtetojë të drejtat e tyre ekskluzive të përdorimit mbi ato pyll ose kullote dhe këto as janë regjistruar në zyrtarë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, etj. Po ashtu, mjaft probleme qëndrojnë për të gjitha komunat ku do të bëhet kalimi i parashikuar për të përfunduar brenda një kohe të shkurtër (gjatëmuajori i parë 2008), sipas porosive të Kryeministrit të Shqipërisë dhe programit të masave që ka hartuar Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU).

Shqetësimet kanë të bëjnë kryesisht me kuadrin ligjor aktual, i cili nuk është i qartë e i plotë dhe nuk jep sigurite ligjore, veçanërisht për përdoruesit vendas të pyjeve e kullotave.

Për të patur një pamje më të qartë të problemeve dhe për të dhënë ndihmesën e vet në këtë proces të rëndësishëm, SNV dhe SHKPKK vendosën të ngarkojnë një Konsulent për të bërë një analizë të hollësishme të kuadrit ligjor dhe ndikimeve të tij mbi praktikën e pylltarisë komunale në Shqipëri.

Nga 79 akte të shqyrtuar (pa llogaritur amendimet e ligjeve), rreth 25% e tyre përmendin pyjet dhe kullotat komunale. Nga analiza e të drejtave të pronësive e të përdorimit për pyjet e kullotat komunale del se në aktet ligjore ka mangësi, boshllëqe, mbivendosje kompetencash apo kundërshti që frenojnë procesin e kalimit dhe vetë mbarevajtjen e reformës në këtë sektor.

Më qellim që procesi i kalimit të arrijë synimet e caktuara, është e nevojshme, sikurse del nga analiza e bërë, të përmirësohet e plotësohet kuadri ligjor, duke mbajtur parasysh disa parime kryesore:

- Sektori i pyjeve dhe kullotave komunale duhet të zërë vend në strategjitë kombëtare më përparësi. Në kuadrin e programit kombëtar të pyjeve e kullotave, i cili duhet hartuar sa më parë, të përfshihet objektivi për kalimin e pyjeve dhe kullotave komunale, si dhe strategjia e reformave dhe roli i shtetit, i qeverisjes vendore e përdoruesve (fshat, familje e shoqate) në mbareshtrimin e pyjeve dhe kullotave të veta.
- Në kuadrin e programit të qeverisë për thellimin e decentralizimit dhe uljen e informalitetit edhe në sektorin e pyjeve dhe kullotave, ndryshimet në aktet ligjore duhet

te parashikojne kalimin ne pronesi te komunes ose bashkise te pyjeve e kullotave brenda juridiksionit te tyre, legalizimin - rikthimin dhe njohjen e te drejtes se pronesise tradicionale te pyjeve e kullotave per pretenduesit reale dhe perdoruesit faktike (fshati, fisi, familja, shoqata), si dhe pajisjen e tyre me dokumentat ligjore e regjistrimin ne Zyren per Regjistrimin e Pasurive te Paluajtshme.

- Ne aktet ligjore duhet te behet dallimi midis pyjeve e kullotave qe mbareshtrohen nga komuna per plotesimin e funksioneve te veta (pasi te jene plotesuar me pare nevojat e banoreve te vet) dhe pyjeve e kullotave qe mbareshtrohen nga fshati, familjet bujqesore, shoqata. Duhet te rishikohen kriteret per pyjet e kullotat qe kalohen. Fshati te kete pronat e veta mbi pasurite natyrore. Planet e mbareshtimit duhet te hartohen e zbatohen ne baze fshati dhe permbledheset per komunen.
- Permiresimi i akteve ligjore duhet te njohe te drejten e mbareshtimit nga komuna ose bashkia dhe perdoruesit (fshati, familjet, shoqata), krahas pyllit e kullotes, edhe te kafsheve e shpendeve te egra qe ndodhen ne to, si pjese perberese te ekosistemit unik, si dhe pasurite e tjera natyrore te karakterit vendor (burimet, perrenjte e rezervuaret vendore, guri, rëra e zhavori, peshku, etj.). Po ashtu, duhet te njihet e drejta e perdoruesit (fshati, familjet, shoqata) per shitjen e prodhimeve mbi nevojat e veta, si dhe per te shfrytëzuar pyje e kullota shteterore per te nxjere prodhime per shitje dhe sigurim te ardhurash per zbutjen e varferise, sidomos ne zonat malore (pa tarife ose me tarife fare te ulet), krahas krijimit te instrumentave financiare dhe nxites per te mbeshtetur zhvillimin e pyjeve dhe kullotave komunale, si dhe te pasurive te tjera natyrore ne zonat rurale.
- Njekohesisht me kalimin e siperfaqeve pyjore e kullosore, duhet te behet dhe kalimi i specialisteve perkates, fondeve, mjeteve e pajisjeve te nevojshme nga sherbimi pyjor ne komuna, si dhe i dokumentacionit kadastral, teknik e hartografik. Kryerja e studimeve dhe analizave te rezultateve dhe pervojave te kalimit dhe mbareshtimit te pyjeve e kullotave komunale nga specialiste te sherbimit pyjor, pushteti vendor, Fakulteti i Shkencave Pyjore dhe Agjencite e Mjedisit dhe Pyjeve, evidentimi dhe perhapja e pervojave me te mira nga sherbimi keshillimor, qe duhet te krijohet e funksionojë sa me pare, dhe kualifikimi i punonjesve te qeverisjes vendore, pylltareve komunale e shoqatave.
- Pjesemarrja e gjere e perfaqesuesve te qeverisjes vendore, e sidomos e perdoruesve dhe shoqatave te tyre ne diskutimet per permiresimet dhe plotesimet qe kerkohen te behen ne aktet ligjore eshte kusht per sukses dhe per zbatimin e tyre.
- Gjate permiresimit te akteve ligjore, duhet mbajtur parasysh perafrimi me ligjshmerine evropiane, si dhe tendencat e sotme ne bote per kalimin e pyjeve dhe pronave ne pergjithesi nga perdorimi ne pronesi.

Në fund të prezantimit të tij, Z. Muharremaj nënvizoi se megjithë arritjet, mendimi i mjaft aktoreve eshte se procesi i kalimit ka ecur ngadale dhe, per me teper, nuk eshte perfunduar plotesisht ne asnje komune te vendit, per faktin se familjet bujqesore nuk kane mare ndonje dokument qe te vertetoje te drejta e perdorimit te tyre mbi pyjet dhe kullotat e mara ne perdorim. Kjo ka ndodhur per nje varg aresyesh, por nder me kryesoret jane:

- Mangesite ne aktet ligjore per pyjet dhe kullotat komunale dhe moszbatimi si duhet i tyre;
- Kapacitete te pamjaftueshme te njesive te qeverisjes vendore per te asimiluar procesin;
- Mosnjohja e procesit nga vete perdoruesit dhe mosbesimi qe kane ndaj veprimeve te qeverise, etj.

1.3 Puna në grupe

Gjatë sesionit të tretë të seminarit pjesëmarrësit u ndanë në katër grupe pune për të diskutuar mbi çështjet e mëposhtme:

- *Çështjet e pronësisë* – Grupi i parë
- *Mbarështrimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale dhe roli i Shërbimit Pyjor* – Grupi i dytë
- *Aspektet ekonomike dhe fiskale* – Grupi i tretë
- *Roli i njësive të qeverisjes vendore dhe OJF-ve* – Grupi i katërt

SHKPKK caktoi në çdo grup një lehtësues dhe një raportues si dhe çdo grup u pajis me materiale të shkruara për të fokusuar debatet dhe diskutimet e pjesëmarrësve në çështjet a caktuara për diskutim në grup. Mbledhjet në grupe u karakterizuan nga një frymë debati konstruktiv dhe gjetjet e rekomandimet e grupeve u paraqitën ditën e dytë të seminarit.

1.4 Dita e fundit: mbledhja plenare dhe panel diskutimi

Gjatë ditës së fundit raportuesit e grupeve të punës bënë prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve në mbledhjen plenare. Z. Pal Çoku prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e grupit të parë lidhur me çështjet e pronësisë. Mbarështrimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale dhe roli i Shërbimit Pyjor u prezantua nga Z. Isuf Omuri, raportues i grupit të dytë. Z. . Ferdin Liçaj prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e grupit të tretë mbi aspektet ekonomike dhe fiskale, dhe Z. Xhelal Shyti prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e grupit të katërt mbi rolin e njësive të qeverisjes vendore dhe të organizatave jo-fitimprurëse.

Paneli i diskutimeve për “Përmirësimet ligjore dhe institucionale që nevojiten për të përballuar sfidat e mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave komunale në Shqipëri” përbëhej nga Zëvendës Ministri i MMPAU, Z. Taulant Bino, Z. Pal Çoku, Kryetar i Komunës Ulëz, Znj. Valbona Ylli, Kryetare nderi e SHKPKK, Z. Myzafer Luma, Kryeshf Ekzekutiv i Agjencisë Pyjore Kosovë, Z. Atilla Lengyel, këshilltar për politikën e Konfederatës Europiane të Pronarëve të Pyjeve, Z. Darko Skenderski, Koordinator i Shoqatës së Pronarëve të Pyjeve Privatë, Maqedoni, dhe Z. Thimaq Lako, SHKPKK, i cili moderoi këtë sesion. Paneli i diskutimeve shërbeu si mjet për të gjeneruar diskutime me politikëbërësit mbështetur në diskutimet e seminarit. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit u informuan mbi politikën dhe aksionet qeveritare për procesin e decentralizimit të pronave dhe të mbarështrimit të burimeve natyrore. Mbledhja plenare dhe paneli i diskutimeve evidentuan se seminari kombëtar për përmirësimin e kuadrit ligjor për pyjet e kullotat komunale ishte një ngjarje e mirëpritur nga të gjithë pjesëmarrësit. Gjetjet dhe rekomandimet e sesioneve të seminarit dhe rekomandimet kryesore për politikëbërësit jepen më poshtë.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Duke parë kuadrin ligjor mbi të cilin është mbështetur procesi i kalimit të pyjeve e kullotave komunale dhe përvojën mbi 10 vjetecare të këtij procesi, vërehet se, krahas arritjeve të njohura tashme, ka dhe mangësi, boshllëqe, mbivendosje kompetencash apo kundërshti që frenojnë procesin e kalimit dhe vete mbarevajtjen e reformës në këtë sektor. Vete fakti i rishikimit të shpeshtë të disa akteve tregon se nuk behet punë e thelluar e bazuar në analiza të gjendjes e shkaqeve të moszbatimit të tyre, nuk merret mendimi i qeverisjes vendore dhe përdoruesve e shoqatave të tyre, etj. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore jepen më poshtë.

2.1 Gjetjet dhe rekomandimet kryesore për përmirësimin e dispozitave ligjore lidhur me çështjet e pronësisë

Ne teresine e akteve ligjore te shqyrtuar, aktet per te drejtat e pronesise dhe perdorimit jane me te shumtet ne numer, por jane te pakte ata qe permendin direkt pyjet e kullotat komunale, ndersa ne pjesen tjeter, nepermjet akteve kryesore per fushat e sektorit dhe te prones ne teresi, kane rezultuar dhe norma qe prekin edhe pyjet e kullotat komunale ose nenkuptohen keto te drejta per ngjajshmeri. Me gjithë mbeshitetjen qe kane dhene keto akte ligjore per zhvillimin e sektorit te pyjeve e kullotave ne pergjithesi, dhe fillimin e procesit te kalimit te pyjeve e kullotave komunale ne vecanti, per kete te fundit mjaft prej ketyre akteve paraqesin mangesi dhe boshlleqe qe kerkojne patjeter permiresime e plotesime.

- Komunat e bashkitë nuk janë të mirëinformuara lidhur me procesin e transferimit të pyjeve dhe kullotave dhe nganjëherë ky proces zbatohet në mënyrë krejt mekanike nga Shërbimi Pyjor;
- Komunat duhet të kenë të drejta të plota pronësie mbi burimet natyrore dhe transferimi i pyjeve e kullotave komunale duhet të bazohet në përcaktime ligjore shumë qarta lidhur me “të drejtat e pronësisë” dhe “të drejtat e përdorimit”;
- Transferimi i pyjeve dhe kullotave komunale duhet të shoqërohet nga një proces informimi dhe ndërgjegjësimi, përfshi asistencën teknike dhe trajnimin e personelit të komunës apo bashkisë.
- Komunat e bashkitë të jenë të detyruara që të mos pakësojnë sipërfaqen e pyllit e të kullotës, por në të kundërt të kenë të drejtë të shtojnë sipërfaqen pyjore nëpërmjet ndryshimit të destinacionit të tokave jo-produktive apo të tokave të tjera në pyll.
- Pyjet dhe kullotat komunale duhet të përdoren në mënyrë të përbashkët (si komunë apo fshat), në grup familjesh apo në përdorim familjar, në përputhje me të drejtat zakonore të komuniteteve dhe fshatrave; për pyjet në përdorim të përbashkët të përgjigjet komuna apo fshati, për tipet e tjera të përdorimit të përgjigjen përdoruesit direktë;
- Akti i ri ligjor që duhet të hartohet për pyjet duhet të marrë në konsideratë të tre format e pronësisë: pyjet shtetërorë në zotërim të Shërbimit Pyjor, pyjet komunalë në pronësi të komunave, bashkive dhe të përdoruesve tradicionalë (fshat, ekonomi bujqësore, shoqatë përdoruesish të pyjeve), dhe pyje privatë; në procesin e hartimit të këtij ligji duhet të marrin pjesë të gjithë aktorët dhe grupet e interesit, sidomos në nivel komune, etj.

2.2 Gjetjet dhe rekomandimet kryesore për përmirësimin e dispozitave ligjore lidhur me mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave komunale dhe rolin e Shërbimit Pyjor

Nenet per pyjet dhe kullotat komunale jane shume te pakte ne ligjet baze te sektorit (ligji per pyjet, kafshet e shpendet e egra dhe gjuetine, bimet mjekesore, kullotat) dhe aktet nenligjore perkatese per te perfshire teresine e problemeve qe mbart per mbareshtimi dhe mbrojtja e ndoshta me shume se gjysmen e siperfaqes se fondit pyjor dhe shumicen e siperfaqes se fondit kullor, dhe shume me pak jane per pyjet dhe kullotat ne perdorim te fshatit, familjes dhe shoqates. Ka nje perqendrim te tepruar te kompetencave ne duart e shtetit persa i perket te drejtave dhe pergjegjesive per mbareshtimin, shfrytezimin dhe ruajtjen e pyjeve, psh. kompetencat jane perqendruar tek Shërbimi Pyjor (i) për përgatitjen e programeve të zhvillimit, për mundësinë vjetore të shfrytëzimit, etj.; (ii) për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e mbrojtjes së faunës dhe të gjuetisë; (iii) për administrimin e fondit të bimëve mjekësore nga persona juridikë të licensuar nga ministria, pa ndonjë dallim për territoret e transferuara në komuna, etj. Propozimet kryesore për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me qeverisjen e qëndrueshme të pyjeve dhe kullotave komunale janë si më poshtë:

- Transferimi i pyjeve dhe kullotave shtetërore në komuna duhet të shoqërohet me të drejtat e plota të pronësisë, jo vetëm për drurët dhe barin, por duke i marrë në tërësi si ekosisteme kompleks, së bashku me gjahun, bimët mjekësore dhe çdo gjallesë tjetër që rritet dhe zhvillohet në mjedisin e pyllit e kullotës;
- Në dispozitat ligjore nuk bëhet dallimi midis procedurave për administrimin e fondit pyjor, për hartimin, miratimin dhe zbatimin e masave që parashikohen në planin e mbarshtimit, si dhe për prerjen dhe shitjen e materialit drusor, midis: (i) atyre që zbatohen për pyjet e kullotat për përdorim nga komuna për nevojat e veta (pasi të jenë plotësuar nevojat e banoreve të saj), dhe (ii) atyre që zbatohen për pyjet e kullotat në përdorim të fshatit dhe familjeve bujqësore për nevojat e tyre, ku synimet dhe përdorimet janë krejt të ndryshme;
- Nuk ka kritere dhe rregullore për mbarështimin e qëndrueshëm të pyjeve komunalë: (i) për shfrytëzimin e pyjeve për dru zjarri e lende, (ii) për prodhime jodrusore, (iii) për krasitje e kullotje, (iv) për kullotat në përdorim komunal; (v) për shitjen e materialit drusor e të prodhimeve të tjera kur rezultojnë mbi nevojat e veta (ku duhen theksuar vecoritë perkatese për pyjet në përdorim nga komuna për nevojat e saj, dhe për pyjet në përdorim të përdoruesve - fshati, familjet bujqësore apo shoqatat e tyre), apo (vi) kur jepen pyje e kullota nga shteti për zonat rurale në nevojë për prodhim e shitje për rritjen e të ardhurave të tyre dhe uljen e nivelit të varfërisë.
- Plani i mbarështimit i pyjeve dhe kullotave komunale perkufizohet si një dokument bazë i hartuar sipas njësive të ekonomisë pyjore, kur, në fakt, kriteret për ekonomi pyjore në pyjet e kullotat komunale nuk afrohen kurrësi; po ashtu termat 'rregullat teknike kombetare të shfrytëzimit e aktet kombetare të planifikimit të shfrytëzimit të pyjeve' nuk përdoren në praktikën pyjore e kullotore kur bëhet fjale për zbatime teknike;
- Në dispozitat ligjore nuk shprehet e drejta ekskluzive e familjeve për ngastrat e dhena në përdorim të tyre për t'i shfrytëzuar vetëm ato për nevojat e veta, dhe kur u tepron, të mund t'ua shesin; po ashtu, në rast se nuk mjafton pylli i tyre për nevojat e veta, atyre t'u planifikohet nga pylli i përbashkët i fshatit ose komunes, ose nga pyjet e fshatrave/komunave fqinje, ose nga pyjet shtetërore në afërsi, në marrëveshje me shërbimin pyjor, si për nevojat e veta, ashtu dhe për shitje për sigurim të ardhurash, sipas rregullave të caktuara, etj.

2.3 Gjetjet dhe rekomandimet kryesore për përmirësimin e dispozitave ligjore lidhur me aspektet ekonomike e fiskale

Perpunimi dhe tregtimi i prodhimeve dhe shërbimeve përmendet vetëm në shumë pak akte ligjore çka tregon se të drejtat ekonomike dhe të tregtimit nuk njihen, ato mbahen ende të përqendruara në duart e shtetit dhe u jepen vetëm subjekteve private të licensuara. Në këtë mënyrë, lihet shteg për tregtinë të jashtëligjshme, kontrabandë dhe korrupsion. Nderkaq, nuk bëhen përpjekje për të nxitur shtimin e vlerës së prodhimeve nëpërmjet perpunimit e tregtimit të tyre, çka flet për mangësitë lidhur me zhvillimet e ekonomisë së tregut në sektorin e pyjeve dhe kullotave, vecanërisht lidhur me prodhimet e gjeneruara nga pyjet e kullotat komunale.

- Ka ende përqendrim kompetencash në ministri apo në Shërbimin Pyjor: (i) për caktimin e zonave, afateve, llojeve, sasive dhe dhenien e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë për vjeljen, grumbullimin, perpunimin dhe eksportin e bimeve mjekësore; (ii) për dhënien e lejeve profesionale të ushtrimit të veprimtarisë nga MMPAU, madje edhe për grumbullimin e bimeve mjekësore nga përdoruesit.
- Nuk ka dispozita ligjore për prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve drusore e jodrusore, përfshirë ato nga gjuetia, nga pyjet komunale prej komunes, përdoruesve - fshatit, shoqatës apo familjeve bujqësore (për prodhimet e vjele nga pyjet në përdorim të tyre ose nga pyjet e kullotat publike të dhena nga shërbimi pyjor) për sigurimin e të ardhurave

dhe permiresimin e nivelit te jeteses mjaft te ulet qe kane aktualisht sidomos zonat malore;

- Dispozitat e reja ligjore duhet të përcaktojnë qartë të drejtat që duhet të kenë përdoruesit (komuna, fshati, familjet, shoqatat) për bimët, gjahun, gjahun dhe çdo gjallesë tjetër që rritet dhe zhvillohet në mjedisin e pyjeve e kullotave komunale në pronësi/përdorim të tyre;
- Dispozitat e reja ligjore duhet të ofrojnë mjete nxitëse për mbështetjen e SHPPKK për përfitimin e vlerës së shtuar nga perpunimi i prodhimeve drusore e jodrusore, përfshirë ato të gjuetisë dhe marketimin e tyre.

2.4 Gjetjet dhe rekomandimet kryesore për përmirësimin e dispozitave ligjore lidhur me rolin e komunave e bashkive dhe të organizatave jo-fitimprurëse

Te drejtat fiskale e administrative për pyjet e kullotat komunale, sidomos persa u përket përdoruesve dhe shoqatave të tyre, pothuajse mungojnë krejtësisht. Gjetjet dhe rekomandimet lidhur me rolin e komunave e bashkive dhe të organizatave jo-fitimprurëse janë si më poshtë:

- Përqendrim kompetencash në ministri apo në shërbimin pyjor, nder të tjera për: (i) tarifatat për vjeljen e gjahut dhe ushtrimin e gjuetisë, për hyrjet në rezervatet e gjuetisë, ato faunistike dhe rezervat natyrore; (ii) për konfiskimin e gjahut të vrarë dhe sekuestrimin e armeve dhe mjeteve të gjahut; për vendosjen, marjen e vendimit dhe vjeljen e gjobave; (iii) caktimi i tarifave për vjeljen dhe grumbullimin e bimëve mjekësore; (iv) për marjen e vendimit për kundërvajtjet administrative (në projekt ligjin për bimët mjekësore), etj.;
- Komunat dhe bashkitë, sidomos në ato zona ku janë transferuar pyjet e kullotat, janë shumë të varfëra dhe nuk kanë burimet e duhura njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme për qeverisjen e qëndrueshme të burimeve natyrore (kryesisht pyje dhe kullota); për të kapërcyer këto pengesa duhet të zhvillohen aktivitete të ndryshme sidomos lidhur me forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore;
- Mungojnë detyrat që duhet të kenë institucionet qendrore dhe autoritetet e qeverisjes vendore për të planifikuar çdo vit fonde për kompensimin e humbjeve të përdoruesve të pyjeve e kullotave komunale nga kufizimet e veprimtarive ekonomike të banorëve në zonat e caktuara për mbrojtjen e biodiversitetit brenda territorit në juridiksion të tyre;
- Nuk ka rregulla, kritere dhe procedura për shitjen e prodhimeve drusore e jodrusore, të bimëve mjekësore dhe prodhimeve të gjuetisë, si dhe prodhimeve të tjera nga pyjet e kullotat komunale e pasurite natyrore vendore, kur rezultojnë mbi nevojat e veta, për sigurimin dhe përdorimin e të ardhurave (nga komunat prej pyjeve/kullotave që përdorin për funksionet e veta, dhe nga përdoruesit e shoqatave prej pyjeve e kullotave në përdorim të tyre, apo nga shfrytëzimi i pyjeve e kullotave shtetërore të dhëna për zonat rurale në nevojë për rritjen e të ardhurave, të drejtat e shoqatave për sigurim të ardhurash, etj.);
- Tarifatat për pyjet dhe kullotat komunale duhet të caktohen nga komunat e bashkitë (që janë në kompetencë të tyre), sipas kushteve të rrethanave vendore;
- Dispozitat e reja ligjore duhet të përcaktojnë qartë të drejtat dhe përgjegjësitë që duhet të kenë fshati, përdoruesit dhe shoqatat e përdoruesve për gjenerimin e të ardhurave nga aktivitetet me bazë pyllin, kullotat, gjuetinë, bimët mjekësore, etj., dhe stimujt për mbarështrimin e qëndrueshëm të tyre; për administrimin dhe ri-investimin e të ardhurave dhe të fondeve publike e private të dhëna për pyjet e kullotat komunale; dispozitat e reja gjithashtu duhet të ofrojnë masa nxitëse në rastet kur përdoruesi investon vetë për të përmirësuar një pyll apo kullotë komunale të degraduar apo për pyllëzim, ose në tokat e pardara e ato bujqësore me prodhimtari të ulët, duke u përjashtuar nga taksat deri sa të hyjnë në prodhim, në ngajshmeri me kulturat drufrutore dhe vreshtarinë, sipas kushteve të caktuara.

PROGRAMI I SEMINARIT

“Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri”

Seminar Kombëtar
12 - 13 Mars 2008
Hotel Tirana Internacional

Dita e parë, 12 Mars 2008

09:30 Regjistrimi

Sesioni i parë:

10:00 Fjala e mirëseardhjes nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave – *Prof. Dr. Lufter XHUVELI*

10:20 Njohja me objektivat e seminarit – *Z. Jack CORTENRAAD, SNV Albania*

10:30 Strategjia e MMPAU për zbatimin e programit të Qeverisë mbi transferimin e pyjeve dhe kullotave shtetërore në pronësi/përdorim të njësisve të qeverisjes vendore – *Z. Taulant BINO, Zevendes Minister i MMPAU*

10:45 Zbatimi i metodologjisë për transferimin e pronave shtetërore në njësitë e qeverisjes vendore: konteksti, sfidat dhe metodologjia e përdorur – *Mrs. Dhurata ÇUPI, Ministria e Brendëshme*

11:00 ***Pushim për kafe***

Sesioni i dytë:

11:30 Programi i Forumit për Zhvillimin e Zonave Malore – *Z. Rexhep Uka, Kuvendi i Shqipërisë*

11:45 Përshkrim i shkurtër i dinamikës aktuale për mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave komunale në Shqipëri – *Z. Thimaq LAKO, SHKPKK*

12:00 Analiza e kuadrit ligjor ekzistues në Shqipëri mbi pyjet dhe kullotat komunale – *Z. Vezir MUHARREMAJ, SHKPKK*

12:40 Pyetje nga pjesëmarrësit

13:00 ***Dreka***

Sesioni i tretë:

14:30 Punë në grupe

Grupi i parë: ***Çështjet e pronësisë***

Grupi i dytë: ***Mbarështrimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale dhe roli i Shërbimit Pyjor***

Grupi i tretë : ***Aspektet ekonomike dhe fiskale***

Grupi i katërt: ***Roli i njësisve të qeverisjes vendore dhe OJF-ve***

17:00 Mbyllja e aktiviteteve të ditës së parë

Dita e dytë, 13 Mars, 2008

Sesioni i katërt:

- 9:00 Përgatitja e prezantimeve nga grupet e punës
10:00 Përmbledhje e punimeve të ditës së parë
10:10 Prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore nga grupet e punës
Çështjet e pronësisë
Mbarështrimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave komunale dhe roli i Shërbimit Pyjor
Aspektet ekonomike dhe fiskale
Roli i njësisë të qeverisjes vendore dhe OJF-ve
- 11:30 ***Pushim për kafe***

Sesioni i pestë:

- 12:00 **Panel Diskutimesh:** “Përmirësimet ligjore dhe institucionale që nevojiten për të përballuar sfidat e mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave komunale në Shqipëri”
13:00 Konkluzionet dhe rekomandimet e seminarit – *Z. Taulant BINO, Zevendes Minister i MMPAU*
13:10 Mbyllja e aktivitetit
- 13:30 ***Dreka***

LISTA E PJESEMARRESVE

SEMINAR KOMBETAR

“Përmirësimi i kuadrit ligjor për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri”

Hotel Tirana Internacional, 12-13 Mars, 2008

Nr	Emri i pjesemarrësve	Organizata/Institucioni	Funksioni	E-mail
1	Z. Lufter Xhuveli	Ministria e Mjedisit e Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU)	Minister	lxhuveli@moe.gov.al
2	Z. Rexhep Uka	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	rexhepuka@yahoo.com
3	Z. Idriz Xhomara	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	
4	Z. Petrit Gjoni	Kuvendi i Shqipërisë	Deputet	
5	Z. Taulant Bino	MMPAU	Zevendes Minister	tbino@moe.gov.al
6	Z. Auron Meneri	MMPAU, Kabineti i Ministrit	Shef kabineti	ameneri@moe.gov.al
7	Z. Tome Therçaj	MMPAU, Kabineti i Ministrit	Zedhenes i Ministrit	tthercaj@moe.gov.al
8	Znj. Magdalena Koja	MMPAU, Sektori i Sherbimit Ligjor	Jurist	mkoja@moe.gov.al
9	Znj. Ilda Llaha	MMPAU, Sektori i Sherbimit Ligjor	Jurist	illaha@moe.gov.al
10	Z. Haki Zoto	MMPAU, Drejtoria e Përgjithëshme e Mbr. Natyrës	Përgjegjes i Sektorit të Faunes	hzoto@moe.gov.al
11	Z. Nehat Collaku	MMPAU, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave	Drejtor	nehatcollaku@yahoo.com
12	Z. Preng Prenga	MMPAU, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave Komunale	Shef sektori	prenga_preng@yahoo.com
13	Z. Hasan Cani	MMPAU, Sektori i Menaxhimit të Pyjeve, DFPP	Shef Sektori	hasan_cani@yahoo.com
14	Z. Haki Kola	Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore	Ekspert i Pyjeve Komunale	haki_kola@yahoo.com
15	Z. Sami Cenko	Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore	Ekspert i Pyjeve Komunale	scenko@yahoo.com
16	Znj. Dhurata Cupi	Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Transferimit të Pronave Publike	Drejtoreshë	dh_cupi@yahoo.com
17	Znj. Ariana Koça	MMPAU, Drejtoria e Përgjithëshme e Mbr. Natyrës	Specialiste	akoca@moe.gov.al
18	Znj. Arjana Sinojmeri	MMPAU, Drejtoria e Përgjithëshme e Mbr. Natyrës	Specialiste	asinoimeri@moe.gov.al
19	Z. Leonidha Peri	Fakulteti i Shkencave Pyjore	Zevendes Dekan	lperi@gmx.de
20	Znj. Drita Dade	Banka Boterore	Oficer projektësh	ddade@worldbank.org
21	Z. Carl Vonnessen	Banka Boterore, SIDA, Suedi	Oficer projektësh	cvonessen@worldbank.org
22	Znj. Elvira Bazina	EDEM / USAID	Specialist i Zhvillimit të Biznesit	Elvira_Bazina@dai.com
23	Z. Xhevat Lushi	MBPZHR, Kosovë	Këshilltar Politik i Ministrit	xhevat.lushi@ks-gov.net
24	Z. Myzafer Luma	Agjencia Pyjore e Kosovës	Kryeshf Ekzekutiv	myzafer.luma@ks-gov.net
25	Z. Adnan Basha	Instituti i Pyjeve, Pejë, Kosovë	Drejtor	
26	Z. Faruk Bojaxhi	Agjencia e Pyjeve Kosove	Inxhinier përgjegjes	farukbojaxhi@hotmail.com

Nr	Emri i pjesemarrësve	Organizata/Institucioni	Funksioni	E-mail
27	Z. Darko Skenderski	Shoqata e Pronarëve të Pyjeve, Maqedoni	Koordinator	
28	Z. Atilla Lengyel	Konfederata Evropiane e Pyjeve Private	CEEC, keshilltar	Lengyel@cepf-eu.org
29	Z. Peter Troste	SIDA	Konsull, Drejtues Programesh	peter.troste@sweden.gov.al
30	Z. Peter Kempen	SNV Maqedoni	Drejtor	pkempen@snnworld.org
31	Znj. Anela Stavrevska	SNV Maqedoni	Keshilltare	astavreska@snnworld.org
32	Z. Jack Cortenraad	SNV Shqiperi	Drejtor	jcortenraad@snnworld.org
33	Znj. Fuji Kreider	SNV Tirana	Koordinator i Zyres, Tirane	fcrieder@snnworld.org
34	Z. Arie Klop	SNV Tirana	Ekspert i Pyjeve Komunale	aklop@snnworld.org
35	Z. Janaq Male	SNV Tirana	Ekspert i Pyjeve Komunale	jmale@snnworld.org
36	Z. Stavri Pllaha	SNV Korca	Ekspert i Pyjeve Komunale	splaha@snnworld.org
37	Znj. Elona Stefanllari	SNV Korca	Keshilltar i Pyjeve Komunale	estefanllari@snnworld.org
38	Z. Isuf Omuri	SNV Rajoni i Dibres	Ekspert i Pyjeve Komunale	iomuri@snnworld.org
39	Z. Hamit Salkurti	SNV Diber	Keshilltar i Pyjeve komunale	hsalkurti@snnworld.org
40	Z. Pal Çoku	Komuna Ulez	Kryetar Komune	
41	Z. Eduart Cani	REC Tirana	Menaxher Projektsh	edi@albania.rec.org
42	Z. Genci Kacorri	Instituti i Studimeve dhe Projektmeve Pyjore	Specialist	benimpex@sanx.net
43	Z. Gjon Fierza	Shoqata e Pyjeve dhe Komunave	Kryetar i Shoqates	fierzagj@yahoo.com
44	Z. Abdulla Diku	Shoqata e Pyjeve private	Kryetar i Shoqates	adiku@hotmail.com
45	Z. Them Perri	Shoqata Kombetare e Gjuetise	Kryetar i Shoqates	themiperri@yahoo.com
46	Znj. Zhaneta Prifti	Shoqata e Ndergjegjesimit per Progres	Kryetare e Shoqates	zhprifti@abissnet.al
47	Z. Mehmet Meta	Shoqata Pyjore 'AlbaForest'	Drejtor Ekzekutiv	albaforest@yahoo.com
48	Z. Kristaq Shore	Shoqata Nderkufitare e Faunes	Anetar i Bordit	kristaqshore@hotmail.com
49	Z. Skender Lata	Drejtoria e Sherbimit Pyjor, Mat	Drejtor	
50	Z. Bajram Sallaku	Drejtoria e Sherbimit Pyjor, Bulqize	Drejtor	
51	Z. Abedin Paci	Drejtoria e Sherbimit Pyjor, Peshkopi	Drejtor	
52	Z. Pirro Pojani	Drejtoria e Sherbimit Pyjor, Korce	Shef Sektori te Menaxhimit te Pyjeve	
53	Z. Mihallaq Qirjo	Projekti i Zhvillimit te Burimeve Natyrore	Koordinator Rajonal	
54	Z. Ahmet Mehmeti	Klubi Ekologjik, Elbasan	Kryetar	ahmetecel@yahoo.com
55	Znj. Marieta Mima	ECAT Tirana	Drejtoresh Ekzekutive	mima@ecat-tirana.org
56	Z. Edmond Pasho	Konsulent i lire	Specialist pyjesh	
57	Z. Harko Koster	SNV Albania	Konsulent per pyjet komunale	hkoster@yahoo.com
58	Z. Myftar Sfarça	Prishtinë, Kosovë	Inxhinier pyjesh	
59	Z. Qemal Rama	Komuna Grekan	Kryetar komune	
60	Z. Isuf Salla	Federata Rajonale e Pyjeve Komunale, Elbasan	Specialist pyjesh	
61	Z. Arsen Proko	Fakulteti i Shkencave Pyjore	Pedagog	aproko@albmail.com
62	Z. Trifon Cfaraku	Shoqata e pyjeve komunalë, Stëblevë	Kryetar	
63	Znj. Aida Tafili	MMPAU, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave Komunale	Specialiste	

Nr	Emri i pjesemarrësve	Organizata/Institucioni	Funksioni	E-mail
64	Z. Admir Seci	MMPAU, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave Komunale	Specialist	
65	Znj. Eva Gjokolli	ATSH	Gazetare	evgjokolli@hotmail.com
66	Z. Semi Numani	MMPAU, Sektori i Policisë Pyjore	Specialist	
67	Z. Pashk Prendi	Qebiku shpk	Specialist	
68	Z. Ferdin Licaj	Federata Rajonale e Pyjeve, Tirana	Kryetar i Federates	flicaj_05@yahoo.fr
69	Z. Rexhep Ndreu	Federata Rajonale e Pyjeve, Diber	Koordinator	federatapk_diber@yahoo.com
70	Z. Rruzhdin Hymetllari	Federata Rajonale e Pyjeve, Korce	Koordinator	
71	Z. Xhelal Shuti	Federata Rajonale e Pyjeve, Kukes	Koordinator	fedkuk@yahoo.com
72	Z. Sokol Guri	Federata Rajonale e Pyjeve, Shkoder	Koordinator	
73	Z. Zef Krepi	Federata Rajonale e Pyjeve, Lezhe	Koordinator	
74	Z. Gjon Deda	Federata Rajonale e Pyjeve, Puke	Koordinator	
75	Z. Ndriçim Cela	Federata Rajonale e Pyjeve, Elbasan	Koordinator	
76	Z. Sokrat Kerri	Federata Rajonale e Pyjeve, Berat	Koordinator	
77	Z. Vezir Muharremaj	Shoqata Kombetare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale Tirana (SHKPKK)	Specialist	vmuharremi@hotmail.com
78	Znj. Valbona Ylli	SHKPKK	Lehtesuese	vylly@yahoo.com
79	Mr. Thimaq Lako	SHKPKK	Lehtesues	thlako@icc-al.org
80	Znj. Sheza Tomcini	SNV Diber	Lehtesues	stomcini@snnworld.org
81	Znj. Almira Xhembulla	SNV Diber	Lehtesues	axhembulla@snnworld.org
82	Z. Genti Kromidha	SHKPKK	Perkthyes	gkromidha@yahoo.it
83	Znj. Blerta Koco	SHKPKK	Lehtesuese, Studente	Koco_blerta@yahoo.fr
84	Z. Ervin Cfaraku	SHKPKK	Lehtesues, Student	ervincfaraku@gmail.com